



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 31

Prishtinë, më 20.1.2009, ora 13,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL
nga mbledhja e Komisionit

Në mbledhje **morën pjesë**: Lulzim Zeneli, Myrvete Pantina, Berat Luzha, Selvie Halimi, Heset Cakolli, Elhëme Hetemi, Ibrahim Selmanaj, Zulfi Merxha dhe Ali Lajçi.

Munguan : Dragisha Miriç dhe Zef Morina .

Të ftuarit dhe pjesëmarrësit tjerë : Maria Berishaj-OSCE dhe zyrtarët nga MMPH: Nezakete Hakaj dhe Nazmi Shkodra.

Nga stafi mbështetës i komisionit : Bajram Badivuku, Drita Çarkaxhiu

Mbledhjen e kryesoi : **Lulzim Zeneli**, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,**
- 2. Shqyrtimi i projektligjit për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes,**
- 3. Të ndryshme.**

Kryesuesi Lulzim Zeneli, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes dhe hapi mbledhjen për pikat e rendit të ditës, mirëpo paraprakisht paraqiti pasqyrën e punës së deritanishme rreth shqyrtimit të projektligjeve në fushveprimtarinë e këtij komisioni. Për p/l e Tokës Ndërtimore, privatizimin... tha se duhet të ftohen ekspertët përkatës, ngase ka vërejtje të shumta të cilat e bëjnë të pamundur amendamentimin e këtij projekti. Në procedurën e shqyrtimit në këtë komision janë edhe 4 projekte, ndërkaq për 5 projektligje të cilat gjenden në procedurën e shqyrtimit nga komisionet kryesore propozoi të kërkohet sqarim nga sekretaria për arsyen e vonesës së tyre, sidomos të projektligjeve të cilat janë dorëzuar më herët. **Myrvete Pantina**, anëtare e komisionit për Buxhet, njoftoi se ky komision në mbledhjen e radhës do të shqyrtoi projektligjet që janë dërguar nga ana e këtij komisioni. **Selvie Halimi** ishte e mendimit se urgjenca duhet të dërgohet Sekretarisë por pastaj duhet të mbahet një takim me dy ministrat dhe me dy kryetarët e komisioneve kryesore. **Lulzim Zeneli** tha se shumë shpejt kryetari i Kuvendit do të mbaj një takim me kryetarët e komisioneve ku me siguri do të qartësohen gjërat. Megjithatë komisioni nxori :

P Ë R F U N D I M

Të kërkohet nga Sekretaria e Kuvendit shpjegimi për arsyen e mospërfundimit të 5 (pesë) projektligjeve të dërguara nga ky komision tek komisionet kryesore, sidomos të atyre që janë dërguar më herët (Projektligji për shitjen e banesave dhe projektligji për Ushqimin).

Lidhur me **projektligjin për Produktet Biocide** i cili do të jetë në shqyrtim të seancës plenare më 22.1.2009 për lexim të parë, Komisioni nuk kishte ndonjë vërejtje në aspektin e miratimit në parim.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Kryesuesi konstatoi miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar pa vërejtje. **Elhëme Hetemi** kërkoi korrektimin e diskutimit nga mbledhja e kaluar si vijon : **“E.H.** tha se duhet eliminuar dilemat e APK në mënyrë që të ngjallet optimizmi, dmth të sqarohet për rojet e pyllit se a duhet të trajtohen si shërbyes të Policisë së Kosovës apo punëtorë në kuadër të APK, gjithashtu bashkëpunimi me qytetarë të jetë në nivelin e lartë derisa të shohim se po fillon arritja e rezultateve”.

2. Shqyrtimi i projektligjit për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes

Kryesuesi Lulzim Zeneli hapi këtë pikë duke sugjeruar që shqyrtimi i projektligjit të filloi nen për nen duke inkorporuar vërejtjet e grupit punues dhe të tjera.

Preambula

Të përmirësohet sipas kushtetutës.

Neni 2

Për disa shprehje teknike gjuhësore në këtë projektligj dhe në disa projektligje tjera të shqyrtuara më parë **Selvie Halimi** tha se në fund patjetër duhet të ketë intervenim gjuhësor, çka në fakt nuk është duke u bërë.

Pika 5 e Nenit 2 të riformulohet nga MMPH.

Amendamenti 1

Riformulohet pika 7 dhe 9 e Nenit 2 si vijon:

7. Autoriteti Republikan është organ qeveritar i autorizuar për zbatimin e dispozitave të këtij ligji.

Si rrjedhojë e këtij riformulimi, në tërë tekstin e projektligjit “Autoriteti kompetent” zëvendësohet me **Autoriteti Republikan**.

9. Autoriteti Komunal nënkupton organin kompetent në nivel të Komunës.

Në pikën 12, në fillim riformulohet fjalia si vijon : **“leja” është dokument me shkrim i autoriteteve Republikane...**” dhe vazhdon : **...që lejon...**”. Më tutje fshihet lidhësja “dhe” në reshtin e 4, ndërsa në reshtin e 5 fshihet “integruara”.

Lidhur me këtë përkufizim, komisioni (Selvie Halimi, Ali Lajçi, Elhëme Hetemi) debatoi rreth çështjes se a paraqet leja vendim dhe a duhet të shkruhet “është vendim”.

Pika 16, riformulohet :

Publiku nënkupton një ose më shumë persona juridik ose fizik, grupet, shoqatat ose organizatat.

Në pikën 17, në reshtin e 2, “me gjasë do” zëvendësohet me **“mund”**, ndërsa në reshtin e 4 “azhurnim” zëvendësohet me “përsheptim”.

Te pika 19, në reshtin e parë hiqen dy pikat pas fjalës “përfshijnë”.

Te pika 20, në reshtin e parafundit “sa” bëhet “se”.

Përkufizimi 21, fshihet.

Te Neni 3, komisioni ndërpreu punimet rreth këtij projektligji, për të vazhduar në mbledhjen e radhës.

3. Të ndryshme

Në takimin joformal para se të filloi kjo mbledhje, të kryetarit të komisionit dhe zyrtarit të MBPZHR , është aritur pëlqimi për pikën 3 të rendit të ditës në mbledhjen e radhës : Programi për Zhvillimin e Sektorit Pyjor , informatë kjo e cila është dorëzuar anëtarëve të komisionit dhe e cila do të diskutohet në mbledhjen e datës 27.1.2009.

Mbledhja përfundoi në orën 14,45.

Kryetari i Komisionit,
Lulzim Zeneli